



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ

Nr. ____, datë _____

**PËR KODIN E SJELLJES PËR INTEGRITET NË KËRKIMIN SHKENCOR
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË VENDOSI:

KREU I PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE PËRKUFIZIME

Neni 1
Objekti

Kodi i Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, më poshtë Kodi i Etikës, përmban parimet dhe normat themelore të sjelljes së institucioneve të arsimit të lartë dhe atyre si edhe personelit të tyre akademik a kërkues shkencor, konform Kodit European të Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor.

Neni 2
Qëllimi

1. Qëllimi i Kodit të Etikës është të kthejë në normë ligjore Kodin European të Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor¹ dhe të shërbejë si një kornizë vetërregulluese për ushtrimin dhe mbajtjen e përgjegjësisë ligjore, institucionale, profesionale, morale e shoqërore të institucioneve dhe të pjesëtarëve të komuniteteve akademike e shkencore.
2. Kodi i Etikës synon të ruajë, të garantojë dhe të mbrojë pastërtinë dhe integritetin akademik, profesional, institucional dhe moral të veprimtarisë akademike e kërkimore-

¹ *The European Code of Conduct for Research Integrity*, Revised Edition; ALLEA - All European Academies, Berlin, 2017.

shkencore në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare bashkëkohore të veprimtarisë akademike dhe të kërkimit shkencor.

Neni 3 **Fusha e zbatimit**

1. Kodi i Etikës zbatohet gjatë kërkimit në të gjitha fushat e veprimtarisë kërkimore dhe akademike, të shkencës, të dijes e kërkimit dhe është i detyrueshëm për zbatim nga të gjitha institucionet kërkimore dhe akademike, publike e private, me financim publik ose privat, si edhe nga të gjithë punonjësit akademikë e të kërkimit shkencor dhe të dijes në Republikën e Shqipërisë.

2. Kodi i Etikës zbatohet duke respektuar dallimet midis institucioneve të disiplinave shkencore e të kërkimit: Akademia e Shkencave, institucionet e arsimit të lartë, institucionet kërkimore, organizatat dhe shoqatat e dijes, si dhe kërkuesit që kryejnë kërkim publik e privat, botuesit dhe organet e tjera të lidhura me veprimtarinë akademike e kërkimore zhvillojnë dhe mbajnë përgjegjësitë e veta në vëzhgimin dhe zbatimin e parimeve dhe praktikave të sjelljes me integritet.

Neni 4 **Premisa**

1. Kodi i Etikës nisët nga premisa se kërkimi shkencor është një ndërmarrje e përbashkët, që kryhet në institucionet kërkimore e akademike, në qendrat kërkimore, në industri apo në mjedise të tjera, në sektorin publik dhe privat. Kërkimi përfshin bashkëpunimin, e drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të institucioneve dhe individëve, i cili ushtron ndikim në zhvillimin ekonomik, social, politik dhe kulturor.

Neni 5 **Përkufizime**

Termat e përdorur në këtë kod kanë kuptimet si më poshtë:

Bashkautorësia është kryerja e një punimi në grup, me më shumë se një anëtar.

Botim grabitqar është botimi që dëmton dhe pengon kontrollin e cilësisë së kërkimit shkencor.

Fabrikimi është sajimi i rezultateve të kërkimit dhe regjistrimi i tyre sikur të ishin të vërteta.

Falsifikimi është manipulimi i materialeve, pajisjeve dhe/ose proceseve të kërkimit, ndryshimi, heqja a shmangia e të dhënave ose e rezultateve, në mënyrë të pajustificuar ose prezantimi i një punimi ose botimi si me vlera shkencore, pa qenë i tillë.

Institucionet e arsimit të lartë janë institucionet e arsimit të lartë që ngrihen në bazë të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Institucionet kërkimore janë institucionet që ngrihen në bazë të legjislacionit për shkencën.

Kërkimi shkencor është një ndërmarrje e përbashkët, që kryhet në institucionet e arsimit të lartë, qendrat kërkimore, në industri apo në mjedise të tjera, në sektorin publik dhe privat dhe synon arritje të reja në fushën e shkencës dhe teknologjisë.

Kodi i Etikës është korniza e përgjegjësive morale e ligjore e komuniteteve akademike e shkencore dhe pjesëtarëve të tyre.

Kolegji i Etikës është instanca më e lartë e shqyrtimit të ankimimeve dhe vendosjes së sanksioneve për shkeljet e integritetit në bazë të këtij ligji.

Komunitetet akademike e shkencore janë bashkësitë e punonjësve dhe mjedisi ku zhvillohet veprimtaria mësimdhënëse dhe kërkimore.

Konflikti i interesave në vlerësime është ripërfshirja e personave në çdo fazë të shqyrtimit a vlerësimit të një punimi, objekt ankimimi, në të cilin kanë qenë pjesëtar, ose në lidhje të mëparshme këtë punim ose me autorin/autorët.

Liria akademike dhe e kërkimit shkencor është e drejta për të përcaktuar çështjet akademike dhe të kërkimit, për të zhvilluar teori, për të grumbulluar të dhëna empirike dhe për të përdorur metoda të përshtatshme kërkimore në mënyrë të pavarur dhe pa ndikime që nuk lidhen me kërkimin.

Parimet e kërkimit shkencor janë parimet që orientojnë kërkuesit në veprimtarinë kërkimore.

Përgjegjësia akademike e kërkimore është detyrimi për të zbatuar parimet, normat, standardet dhe kriteret e etikes së kërkimit në institucionet e arsimit të lartë dhe ato kërkimore.

Plagjiatura është përdorimi i ideve dhe punës së të tjerëve si të vetat, pa cituar burimin origjinal, duke shkelur të drejtat e autorëve dhe produktet e tyre intelektuale.

Procedurat e kërkimit shkencor përfshijnë pyetjet kërkimore, hipotezat, analizën, formulimin e rekomandimeve, përdorimin e burimeve dhe raportimin e rezultateve të kërkimit shkencor.

Sanksionet janë masat disiplinore dhe penalizuese që merren nga institucionet e arsimit të lartë dhe ato kërkimore ndaj punonjësve të tyre që kryejnë shkelje të integritetit në kërkimin shkencor.

Shkelje apo shkelje të të rënda të integritetit në kërkimin shkencor janë veprime që kryhen në bazë të përcaktimeve të këtij ligji.

Veprimtaria akademike është veprimtaria mësimdhënëse e kërkimore që zhvillohet në institucione të arsimit të lartë dhe ato kërkimore.

KREU I DYTË

PARIMET E VEPRIMTARISË AKADEMIKE DHE TË KËRKIMIT SHKENCOR

Neni 6

Liria akademike dhe e kërkimit shkencor

Veprimtaria akademike dhe kërkimi shkencor ngrihen mbi lirinë për të përcaktuar çështjet akademike dhe të kërkimit, për të zhvilluar teori, për të grumbulluar të dhëna empirike dhe për të përdorur metoda të përshtatshme. Veprimtaria akademike dhe kërkimi shkencor zhvillohen në mënyrë të pavarur nga çdo presion që synon ndikimin negativ mbi kërkimin dhe rezultatet e tij si edhe nga ndikimet ideologjike, politike, ekonomike, teknologjike, ose nga ndryshimet në mjedisin e kërkimit.

Neni 7

Përgjegjësia e komuniteteve akademike e shkencore

Komunitetet akademike dhe shkencore kanë përgjegjësinë të zhvillojnë dhe të zbatojnë parimet, normat, standardet dhe kriteret e etikes së kërkimit në institucionet dhe disiplinat shkencore përkatëse, si dhe t'u përgjigjen në mënyrën e duhur rreziqeve ose shkeljeve të integritetit.

Neni 8

Parimet e kërkimit shkencor

Parimet themelore të integritetit të kërkimit orientojnë kërkuesit në punën e tyre dhe angazhimin e tyre ndaj sfidave praktike, etike dhe intelektuale që shoqërojnë ose burojnë nga kërkimi shkencor. Këto parime janë:

- i) garancia për cilësinë e kërkimit;
- ii) ndershmëria në zhvillimin dhe në komunikimin e rezultateve me transparencë, drejtësi dhe paanshmëri;
- iii) respekti për kolegët;
- iv) kujdesi për trashëgiminë kulturore dhe mjedisin;
- v) përgjegjësia shoqërore për kërkimin.

Neni 9

Praktikat e mira në kërkimin shkencor

Kërkimi shkencor udhëhiqet nga modeli i praktikave më të mira, të cilat përfshijnë aspektet e mëposhtme:

- i) mjedisin e kërkimit;
- ii) trajnimin për kërkimin;
- iii) udhëheqjen e kërkimit dhe të studiuesit;
- iv) procedurat e kërkimit;
- v) mbrojtjen e studiuesit;
- vi) përdorimin e të dhënave;
- vii) punën në skuadër dhe bashkëpunimin;
- viii) botimin e rezultateve të kërkimit;
- ix) vlerësimin e kërkimit.

Neni 10

Mjedisi i kërkimit

1. Institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet kërkimore promovojnë popullaritetin e shkencës dhe sigurojnë integritetin e procesit të kërkimit.
2. Institucionet e arsimit të lartë dhe ato kërkimore udhëheqin me politika dhe zbatojnë procedurat e mbështetura në praktikat më të mira të kërkimit shkencor.
3. Institucionet e arsimit të lartë dhe ato kërkimore mbështesin me infrastrukturën e nevojshme përdorimin dhe mbrojtjen e të dhënave dhe materialeve të kërkimit në të gjitha format e tyre, të lidhura me riprodhimin, vazhdimësinë e kërkimit dhe përgjegjësinë shoqërore të rezultateve të kërkimit: statistikave, informacionet, protokollin, procesin, dokumentet, produkte të tjera kërkimore, të shoqëruara me të dhënat shpjeguese përkatëse.
4. Institucionet e arsimit të lartë dhe ato kërkimore inkurajojnë promovimin profesional dhe institucional të kërkuesve, nëpërmjet shpërblimit, meritokracisë dhe transparencës.

Neni 11

Trajnimi, mbikëqyrja dhe udhëheqja e kërkimit shkencor

1. Institucionet e arsimit të lartë dhe ato kërkimore krijojnë kushtet dhe ofrojnë garancitë për përditësimin teorik dhe trajnimin metodologjik të studiuesve.
2. Institucionet e arsimit të lartë dhe ato kërkimore mbështesin trajnimin e studiuesve për zbatimin e normave të etikës dhe standardeve të integritetit, të pasqyruara në kodet dhe rregulloret përkatëse për kërkimin shkencor.
3. Kërkuesit më të vjetër dhe drejtuesit e kërkimit këshillojnë, mbështesin dhe nxisin zhvillimin e aftësive profesionale të kërkuesve më të rinj.

KREU I TRETË

PROCEDURAT NË VEPRIMTARINË AKADEMIKE DHE NË KËRKIMIN SHKENCOR

Neni 12

Parimet e procedurave të kërkimit shkencor

1. Pyetjet kërkimore dhe hipotezat mbështeten në kontekstin dhe nevojat e zhvillimit shoqëror.
2. Kërkuesit bëjnë kujdesin më të madh të mundshëm për mënyrat dhe procedurat e analizës, të dokumentimit dhe të formulimit të rekomandimeve të kërkimit shkencor.

3. Kërkuesit përdorin në mënyrë racionale, me përgjegjësi dhe vetëdije të lartë fondet e kërkimit shkencor.
4. Rezultatet, interpretimet, përfundimet dhe rekomandimet e kërkimit shkencor publikohen të qarta, me saktësi e transparencë, duke respektuar fshehtësinë e të dhënave apo të gjetjeve kur kjo është e nevojshme ose kur kërkohet.
5. Kërkuesit raportojnë rezultatet e kërkimeve me standardet e kërkuara dhe atje ku është e zbatueshme, në mënyrë që të jenë të verifikueshme.

Neni 13

Respekti dhe masat mbrojtëse në kërkimin shkencor

1. Kërkuesit veprojnë në përputhje me kodet dhe rregulloret e disiplinave përkatëse të fushave të studimit.
2. Kërkuesit i trajtojnë subjektet e kërkimit, qofshin këto njerëzore, shtazore, kulturore, biologjike, mjedisore, fizike, historike, me kujdes e respekt dhe në përputhje me dispozitat ligjore dhe etike në fuqi.
3. Kërkuesit tregojnë kujdes maksimal për shëndetin, sigurinë, integritetin, dhe mirëqenien e komunitetit, të bashkëpunëtorëve dhe të personave të tjerë që marrin pjesë ose që janë të lidhur me kërkimin.
4. Protokollet, metodologjitë dhe teknikat e kërkimit respektojnë ndjeshmëritë që lidhen me diferencat moshore, gjinore, seksuale, kulturore, fetare, etnike, ekonomike, financiare dhe sociale midis komuniteteve, individëve, bashkëpunëtorëve dhe të personave të tjerë që marrin pjesë ose që janë të lidhur me kërkimin.
5. Kërkuesit shmangin rreziqet dhe dëmet e mundshme që kërkimi mund të shkaktojë mbi komunitetet, individët, mjedisin, trashëgiminë historike e kulturore, si dhe perspektivat e zhvillimit në territorin ku kryejnë studimet.

Neni 14

Përdorimi dhe ruajtja e të dhënave

1. Kërkuesit, institucionet e arsimit të lartë dhe ato kërkimore mundësojnë ruajtjen e sigurt të të dhënave e të materialeve kërkimore, përfshirë ato të pabotuara, për një periudhë kohore të arsyeshme.
2. Kërkuesit, institucionet e arsimit të lartë dhe ato kërkimore sigurojnë që qasja në të dhënat të jetë e hapur sa më shumë të jete e mundur: e gjatshme, e arritshme, ndërvepruese, transparente, e ripërdorshme. Qasja në të dhënat mund të kufizohet aq sa e vlerësojnë të nevojshme këto institucione, me qëllim që të ruajnë të dhënat mbi çështje të sigurisë së vendit ose nëse kërkohet nga financuesit e kërkimit.
3. Kërkuesit, institucionet e arsimit të lartë dhe ato kërkimore prodhojnë të dhëna dhe produkte legjitime dhe mundshme për t'u cituar, në bazë të standardeve të citimit, të parashikuara nga APA, Shoqata Amerikane e Psikologjisë.

4. Kërkuesit, institucionet e arsimit të lartë dhe ato kërkimore sigurojnë që çdo kontratë a marrëveshje për publikimin ose përdorimin e rezultateve të kërkimit, të respektojë pronësinë intelektuale dhe mbrojtjen e të drejtave të autorit.

Neni 15 **Përgjegjësia e përbashkët**

1. Të gjithë bashkëpunëtorët në studimet e përbashkëta marrin përgjegjësi për garantimin e integritetit gjatë gjithë fazave të procesit kërkimor.
2. Të gjithë bashkëpunëtorët në studimet e përbashkëta bien dakord qysh në fillim mbi qëllimet e punës kërkimore dhe komunikimin mbi procesin dhe rezultatet e kërkimit në mënyrë sa më transparente e të hapur.
3. Të gjithë bashkëpunëtorët në studimet e përbashkëta bien dakord qysh në fillim mbi standardet për integritetin e procesit kërkimor, mbi ligjet dhe rregulloret që do të zbatohen, mbi mbrojtjen e së drejtës së autorit për bashkëpunëtorët, si dhe mbi procedurat e trajtimit të mosmarrëveshjeve në rastet e shkeljeve të dispozitave të Kodit të Etikës.
4. Të gjithë partnerët në studimet e përbashkëta bien dakord qysh në fillim mbi dërgimin ose jo për botim të rezultateve të kërkimit.

Neni 16 **Bashkautorësia**

1. Të gjithë bashkëpunëtorët në studimet e përbashkëta njohin kontributin e njëri-tjetrit si bashkautorë në të gjitha fazat e kërkimit: konceptimin, mbledhjen e të dhënave, analizën dhe interpretimin e rezultateve.
2. Bashkautorët sigurojnë që puna e secilit të jetë e arritshme për kolegët në procesin e kërkimit, në mënyrë të hapur, transparente, të saktë dhe në kohën e duhur, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet dhe vendoset ndryshe.
3. Të gjithë bashkautorët bëjnë të njohur çdo konflikt interesi, mbështetje financiare ose mbështetje të ndonjë lloji tjetër për kërkimin dhe/ose për botimin e rezultateve.

Neni 17 **Komunikimi i rezultateve të kërkimit**

1. Bashkautorët janë të hapur dhe të ndershëm në komunikimin e rezultateve të kërkimit, ndaj publikut dhe medias.
2. Autorët dhe botuesit i konsiderojnë për botim dhe shpërndarje edhe rezultatet që provojnë hipotezat e kërkimit, ashtu edhe gjetjet që nuk i provojnë ato.

Neni 18 **Shmangia e konfliktit të interesit në vlerësime**

1. Kërkuesit konsiderojnë pjesë të angazhimit të tyre në procesin e kërkimit pjesëmarrjen në recensa dhe në vlerësime të rezultateve.
2. Kërkuesit shqyrtojnë dhe vlerësojnë artikujt për botim dhe materialet kërkimore që u jepen për vlerësim në mënyrë transparente dhe të argumentuar.
3. Vlerësuesit dhe redaktorët që janë në konflikt interesi, sipas përcaktimeve të Kodit Europian të Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor dhe legjislacionit shqiptar për konfliktin e interesit të personave që ushtrojnë funksione publike, tërhiqen nga përfshirja në vendimet mbi botimin, financimin, emërimin, promovimin apo shpërblimin e autorëve të kërkimeve ose botimeve shkencore.
4. Drejtuesit ruajnë anonimatën e vlerësuesit, me përjashtim të rastit kur është vendosur paraprakisht bërja publike e vlerësuesit.
5. Vlerësuesit dhe redaktorët respektojnë të drejtën e autorëve dhe kërkojnë leje prej tyre për të përdorur ide, të dhëna apo interpretime të paraqitura në materialet që vlerësojnë ose redaktojnë.

Neni 19

Kriteret e përfshirjes në kërkimin shkencor

Drejtuesit ose autoritetet përgjegjëse përfshijnë në kërkimin shkencor kërkuesit që zotërojnë njohuritë, metodologjitë dhe praktikën etike të lidhura me fushën e tyre të kërkimit. Shmangia nga kjo përgjegjësi dëmton procesin e kërkimit dhe marrëdhëniet midis kërkuesve, minon besueshmërinë e kërkimit shkencor dhe shkakton shpenzime të pajustificuara të burimeve. Ajo përbën shkelje të integritetit në kërkimin shkencor dhe ndëshkohet me masat e parashikuara në legjislacionin përkatës.

KREU I KATËRT

SHKELJET E INTEGRITETIT NË KËRKIMIN SHKENCOR. VERIFIKIMI, SHQYRTIMI DHE SANKSIONET

I. SHKELJET E INTEGRITETIT NË KËRKIMIN SHKENCOR

Neni 20

Shkeljet e rënda të integritetit në kërkimin shkencor

Përbëjnë shkelje të rënda të integritetit në kërkimin shkencor:

1. Fabrikimi është sajimi i rezultateve të kërkimit dhe regjistrimi e paraqitja e tyre sikur të ishin të vërteta si edhe paraqitja e rreme e rezultateve të kërkimit.
2. Falsifikimi është manipulimi i materialeve, pajisjeve dhe/ose proceseve të kërkimit ose ndryshimi, heqja a shmangia e të dhënave ose e rezultateve në mënyrë të pajustificuar.
3. Plagjiatura është përdorimi i ideve dhe punës së të tjerëve, pa cituar burimin origjinal, duke shkelur të drejtat e autorëve dhe produktet e tyre intelektuale.

4. Pranimi dhe/ose paraqitja e punimeve pranë një organi haptazi jokompetent a të paautorizuar në fushën përkatëse.

Neni 21

Shkelje të tjera të integritetit në kërkimin shkencor

1. Përbëjnë shkelje të integritetit në kërkimin shkencor praktikatat e mëposhtme:
 - i) manipulimi i autorësisë ose denigrimi i rolit të kërkuesve të tjerë në botime;
 - ii) ribotimi i pjesëve thelbësore të botimeve të veta më të hershme si të reja (autoplagjiatura);
 - iii) citimi përzgjedhës, me qëllim për të zmadhuar gjetjet e veta ose të redaktorëve, drejtuesve ose të kolegëve;
 - iv) fshehja e pjesëve të rezultateve të kërkimit;
 - v) lejimi i financuesve/sponsorizuesve të rrezikojnë pavarësinë e procesit të kërkimit ose të raportimit të rezultateve, me qëllim krijimin e kuptimeve të njëanshme ose të paplota;
 - vi) zgjerimi në mënyrë të panevojshme të bibliografisë së studimit;
 - vii) akuzimi me keqdashje të studiuesve të tjerë për sjellje të papranueshme ose shkelje të tjera;
 - viii) zmadhimi i pajustificuar të rëndësisë dhe të zbatueshmërisë praktike të gjetjeve të kërkimit;
 - ix) vonimi ose pengimi i punës së kërkuesve të tjerë;
 - x) keqpërdorimi i pozitës më të lartë për të inkurajuar shkelje të integritetit kërkimor;
 - xi) fshehja e shkeljeve të mundshme të integritetit kërkimor të kryera nga persona të tjerë ose qëndrimet e papërshtatshme ndaj sjelljeve që shkelin Kodin e Etikës, si dhe të shkeljeve të tjera të kryera nga institucionet;
 - xii) themelimi ose mbështetja e revistave a botimeve të tjera grabitqare që minojnë kontrollin e cilësisë së kërkimit;
 - xiii) fshehja e konfliktit të interesit;
 - xiv) si dhe shkelje të tjera etike të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

II. ORGANET E VERIFIKIMIT DHE SHQYRTIMIT

Neni 22

Këshillat e etikës pranë institucioneve të arsimit të lartë e ato kërkimore

1. Shkeljet e integritetit të kërkimit shkencor të parashikuara nga ky ligj shqyrtohen dhe verifikohen nga Këshilli i Etikës, ngritur në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në institucionin ku është konstatuar shkelja.
2. Këshilli i Etikës pranë institucioneve të arsimit të lartë dhe atyre kërkimore kryejnë procedurat e verifikimit dhe të shqyrtimit të shkeljeve të integritetit në kërkimin shkencor dhe marrin vendime mbi bazën e këtij ligji, sipas procedurave.

Neni 23
Kolegji i Etikës pranë Akademisë së Shkencave

1. Pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë ngrihet dhe funksionon Kolegji i Etikës, si organi më i lartë që shqyrton ankimet e palëve ndaj vendimeve të këshillave të etikës. Kolegji i Etikës shqyrton çështje edhe drejtpërdrejt sipas parashikimeve në këtë ligj.
2. Kolegji i Etikës mund të shqyrtojë shkeljet e integritetit në kërkimin shkencor edhe me nismën e tij.

Neni 24
Përbërja e Kolegjit të Etikës

Kolegji i Etikës përbëhet nga shtatë anëtarë, tre prej të cilëve janë përfaqësues të zgjedhur nga radhët e Akademisë së Shkencave, që mbajnë titullin “akademik” ose “akademik i asociuar”, dy anëtarë janë përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë dhe qendrave kërkimore që mbajnë titullin “profesor”, një anëtar i caktuar nga ministria përgjegjëse për shkencën që mban titullin “profesor” dhe një anëtar është jurist që mban së paku gradën “doktor i shkencave”.

Neni 25
Zgjedhja e Kolegjit të Etikës

1. Anëtarët e Kolegjit të Etikës zgjidhen për një mandat katërvjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.
2. Anëtarët përfaqësues të Akademisë së Shkencave propozohen nga Akademia.
3. Anëtarët përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë dhe të qendrave kërkimore caktohen nga Konferenca e Rektorëve, në bazë të propozimeve të institucioneve të arsimit të lartë dhe të qendrave kërkimore.
4. Anëtari përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për shkencën caktohet nga radhët e pedagogëve të institucioneve të arsimit të lartë, me titullin "profesor".
5. Anëtari jurist, propozohet nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe duhet të ketë minimalisht gradën "doktor".
6. Pas propozimeve nga institucionet e mësipërme, ministria përgjegjëse për shkencën konstituon Kolegjin e Etikës.
7. Kryetari i Kolegjit të Etikës zgjidhet prej anëtarëve të Kolegjit, nga radhët e tyre, me votim të fshehtë.
8. Kolegji i Etikës, brenda 2 muajve nga dita e konstituimit, harton dhe miraton rregulloren e procedurave për funksionimin e tij.
9. Anëtarët e Kolegjit të Etikës gëzojnë të drejtën e shpërblimit, masa e të cilit vendoset nga ministria përgjegjëse për shkencën.
10. Burimet financiare për funksionimin e Kolegjit të Etikës përballohen nga buxheti i shtetit, nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për shkencën.

III. PROCEDURAT E VERIFIKIMIT E SHQYRTIMIT DHE PARIMET E PËRGJITHSHME PËR TË

Neni 26

Parimet e shqyrtimit dhe verifikimit

1. Anëtarët e organeve që kryejnë procedurat e verifikimit dhe të shqyrtimit të shkeljeve të integritetit në kërkimin shkencor, ose shqyrtimin e ankimeve, si dhe palët në konflikt, deklarojnë çdo konflikt interesi që mund të lindë gjatë verifikimit.
2. Verifikimi dhe shqyrtimi kryhen me integritet, në mënyrë të paanshme e gjithëpërfshirëse dhe pa cenuar saktësinë, objektivitetin apo plotësinë e këtij verifikimi. Verifikimet kryhen deri në daljen e përfundimeve nga ana e organit shqyrtues.
3. Procedurat e verifikimit kryhen në mënyrë të fshehtë, konform Kodit të Procedurës Administrative, me qëllim mbrojtjen e personave të përfshirë në verifikim.
4. Institucionet akademike dhe kërkimore gjatë verifikimit dhe shqyrtimit, mbrojnë të drejtat e personave që zbulojnë informacionet mbi shkeljet dhe garantojnë mbrojtjen e karrierës së tyre.
5. Procedurat e verifikimit dhe shqyrtimit të shkeljeve janë të hapura dhe publike, për të garantuar transparencën e verifikimit.
6. Personat e dyshuar për shkelje të integritetit në veprimtarinë akademike dhe kërkimin shkencor njihen me detajet e plota të pretendimeve ndaj tyre dhe u lejohet një proces i drejtë dhe i paanshëm për të paraqitur provat dhe për t'u dëgjuar në lidhje me pretendimet ndaj tyre.
7. Procesi dhe vendimet e marra nga organet përkatëse ndaj personave që verifikohen për shkelje të integritetit janë në përpjesëtim me shkallën dhe llojin e shkeljes për të cilën verifikohen.
8. Çdo i dyshuar për sjellje të papranueshme dhe shkelje të integritetit në kërkimin shkencor prezumohet se nuk është shkelës, derisa të provohet e kundërta me vendim përfundimtar.
9. Procesi i verifikimit dhe i shqyrtimit të shkeljeve mbi bazën e këtij ligji pezullohet ose pushohet sipas rastit, për çështjet me objekt, që në bazë të parimit të kompetencës janë duke u shqyrtuar, ose për të cilat është marrë vendim nga organet kompetente, në bazë të legjislacionit në fuqi për të drejtën e autorit ose për pronësinë intelektuale.

Neni 27

Paraqitja e kërkesë-ankesave

1. Kërkesë-ankesat për pretendimet për shkelje të këtij Kodi, si rregull, paraqiten pranë Këshillave të Etikës.

2. Të drejtën e kërkesë-ankesës e kanë individë apo institucioni ku është paraqitur punimi apo punon punonjësi. Të drejtën e kanë jo më pak se tre anëtarë të Këshillit të Etikës.
3. Këshilli i Etikës shqyrton kërkesë-ankesat në respekt të procedurave të parashikuara në këtë ligj dhe atyre të përcaktuara në Rregulloren e Kolegjit të Etikës.
4. Këshilli i Etikës merr vendim brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesë-ankesës.
5. Vendimet e marra nga Këshilli i Etikës në zbatim të nenit 30 të këtij ligji, të cilat parashikojnë gjobë deri në masën 100 mijë lekë, janë tituj ekzekutiv dhe ankimohen drejtpërdrejt në gjykatë.

Neni 28

E drejta për Ankim

1. Çdo person ndaj të cilit është marrë një vendim për gjobë mbi 100 000 lekë apo masë më të rëndë ka të drejtë të paraqesë ankimim në Kolegjin e Etikës pranë Akademisë së Shkencave. Këtë të drejtë e ka edhe iniciuesi i çështjes në rast mospajtimi me vendimin e Këshillit të Etikës. Kërkesa paraqitet brenda 30 ditësh nga marrja e vendimit a njoftimi për të.
2. Vendimet e Këshillit të Etikës për gjobat deri në 100 000 lekë janë tituj ekzekutiv. Ndaj tyre bëhet ankimim direkt në gjykatë.
3. Çdo person ndaj të cilit është marrë një vendim, por që nuk ka marrë formë të prerë, ka të drejtë të paraqesë ankimim në Kolegjin e Etikës.

Neni 29

Procedurat për shqyrtimin e ankesave Kolegji i Etikës

1. Kolegji i Etikës shqyrton ankimin dhe merr vendim, jo më vonë se 30 ditë nga dita e paraqitjes së ankimit.
2. Votimi për shqyrtimin e ankimeve bëhet i fshehtë.
3. Kolegji i Etikës merr vendim me shumicën absolute të të gjithë anëtarëve të tij.
4. Kolegji mund të lejë në fuqi, të ndryshojë pjesërisht, të rrëzojë ose të rikthejë për rishqyrtim vendimin e Këshillit të Etikës.
5. Për kërkesë-ankesat sipas nenit 23, mund t'i drejtohen drejtpërdrejt Këshillit të Etikës ose merren kryesisht prej tij. Në këto raste, Kolegji i kërkon mendim paraprak Këshillit të Etikës.
6. Vendimet e Kolegjit të Etikës janë tituj ekzekutiv.
7. Ankimimet ndaj vendimeve të Kolegjit të Etikës bëhen pranë Gjykatës Administrative të Tiranës.

IV.SANKSIONET

Neni 30

Sanksionet ndaj shkeljeve të integritetit në kërkimin shkencor

1. Ndaj autorëve të punimit, oponentëve dhe udhëheqësve shkencorë, për të cilët provohet se kanë kryer shkelje të integritetit në kërkimin shkencor, vendosen sanksione financiare ose sanksione të tjera, si më poshtë:
 - a. Shkeljet sipas pikave 1 dhe 5 të nenit 21 të këtij Kodi dhe shkelje të ngjashme me to, me gjobë nga 50 000 në 250 000 lekë.
 - b. Shkeljet sipas pikave 2, 3, 6 të nenit 21 të këtij Kodi dhe shkelje të ngjashme me to, me gjobë nga 50 000 në 100 000 lekë.
 - c. Shkeljet sipas pikave 4, 8 dhe 9 të nenit 21 të këtij Kodi dhe shkelje të ngjashme me to, me gjobë nga 50 000 në 250 000 lekë.
 - ç. Shkeljet sipas pikave 7, 10 dhe 11 të nenit 21 të këtij Kodi dhe shkelje të ngjashme me to, me gjobë nga 50 000 në 250 000 lekë.
 - d. Shkeljet sipas pikës 12, 14 dhe 15 të nenit 21 të këtij Kodi dhe shkelje të ngjashme me to, me gjobë nga 50 000 në 100 000 lekë.
 - dh. Shkeljet sipas pikës 13 të nenit 21 të këtij Kodi dhe shkelje të ngjashme me to, me gjobë nga 100 000 në 250 000 lekë dhe heqje të së drejtës së botimit të revistave apo botimeve grabitqare.
3. Në të gjitha rastet kur konstatohet përsëritja e një ose disa prej shkeljeve të mësipërme, rishikohet ose ndërpritet kontrata e punës.
4. Në të gjitha rastet kur konstatohen shkelje për punimet që janë paguar ose botimet që janë shpërblyer, Kolegji vendos kthimin e pagesës ose të shpërblimit pranë institucionit përkatës.
5. Sanksionet për shkeljet vendosen edhe ndaj udhëheqësve shkencorë, oponentëve apo recensuesve, për punimet a botime që kanë udhëhequr apo vlerësuar. Masa për udhëheqësin është sa 50% e masës për autorin, masa për oponentët dhe recensuesit është sa 30% e masës për autorin.

Neni 31

Sanksionet ndaj shkeljeve të rënda të integritetit në kërkimin shkencor

1. Ndaj personave, qofshin autorë, oponentë apo udhëheqës të punimeve, për të cilët provohet se kanë kryer shkelje të rënda të integritetit në kërkimin shkencor, sipas nenit 20 të këtij kodi, vendosen sanksione financiare ose sanksione të tjera.
2. Shkeljet e rënda të integritetit në kërkimin shkencor, kur nuk janë të përsëritura, dënohen me gjobë nga 1 milion në 3 milionë lekë dhe me ndërprerjen e kontratës së punës.
3. Për shkeljet e rënda të konstatuara në punimet ose në dokumentacionin e mbrojtjes së gradave ose titujve shkencorë, vendoset heqja e gradës ose e titullit shkencor.

4. Në të gjitha rastet kur konstatohen shkelje për punimet që janë paguar ose botimet që janë shpërblyer, Kolegji vendos kthimin e pagesës ose të shpërblimit pranë institucionit përkatës.

5. Sanksionet për shkelje të rënda vendosen edhe ndaj udhëheqësve shkencorë, oponentëve apo recensuesve, për punimet a botime që kanë udhëhequr apo vlerësuar. Masa për udhëheqësin është sa 50% e masës për autorin, masa për oponentët dhe recensuesit është sa 30% e masës për autorin.

Neni 32
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pas botimit në Gazetën Zyrtare.

KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI